



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P- 92
Prishtinë, më 4 dhjetor 2009

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 4 DHJETOR 2009**

Në fillim, seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë, ndërsa pjesën e dytë **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 48 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e seancës.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kryesuesi propozoi që pika pestë e rendit të ditës – Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese për masën e përkohshme të parapagimit të RTK-së, të shtyhet për një seancë tjetër të radhës, me arsyetimin se duhen konsultime shtesë me komisionet parlamentare.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 19, 20 e 23 nëntor 2009

Deputeti Driton Tali pati vërejtje në Procesverbalin e datës 19 nëntor 2009, në faqen e dytë, lidhur me evidencimin e një pyetjeje parlamentare, të cilën donte ta parashtronte në seancën e sotme, e cila është korrigjuar sipas kërkesës së tij.

Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 19 nëntor 2009, me vërejtjen e deputetit Driton Tali, ndërsa Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 20 dhe 23 nëntor 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për kryeministrin apo për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave lidhur me memorandumun e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe PTK-së për zbatimin e Projektit për informatizimin dhe kompjuterizimin e të gjitha institucioneve shkollore.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministren Justina Shiroka - Pula lidhur me çështjen nëse duhet Ministria e Minierave dhe e Energjisë të kërkojë nga menaxhmenti i kompanisë “Termokos” përgjegjësi për mos kryerjen e shërbimeve cilësore për ngrohje.

Në mungesë të ministres Justina Shiroka – Pula, pyetjes së deputetit Smaka i'u përgjigj ministri **Ahmet Shala**.

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar lidhur me mungesën e infrastrukturës ligjore për parqet nacionale dhe për zonat e mbrojtura, si dhe trajtimin e tyre nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ministri **Mahir Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për ministrin Ahmet Shala lidhur me numrin e anëtarëve të delegacionit të Kosovës në Forumin e parë investues në Mbretërinë e Bashkuar, të mbajtur ditë më parë në Londër, si dhe për sukseset nga ky takim.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigorisë

Kryesuesi **Xhavit Haliti**, para se të procedojë me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, konstatoi se nuk ka kuorum për të vazhduar punimet. Ai dha një pauzë prej 20 minutash.

Pas kësaj pauze, seancën e kryesoi, **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 52 deputetë. Në mungesë të kuorumit, kryetari dha pauzë dreke deri në orën 13:00.

Pas pauzës, në mungesë të kuorumit, **Kryetari** deklaroi të mbyllur punimet e seancës së sotme, ndërsa dy pikat e mbetura të rendit të ditës do të shqyrtohen në seancën plenare të radhës.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 13:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale